



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 355/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala Kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Dritan Bajramaj nga Komuna e Istogut, paraqitur kundër Kryesuesit të vendvotimit, për shkak të pa mundësisë për të votuar, për Zgjedhjet e Parakohshme në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 16.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e parashtruar nga Dritan Bajramaj nga Istogu.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 13.06.2014, nga Dritan Bajramaj nga Komuna e Istogut, me të cilën pretendon se me datën 08.06.2014, ka qenë i caktuar si vëzhgues i Zgjedhjeve nga partia e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Qendrën e votimit nr.0601C në Istog vendvotimi nr.05R. Rreth orës 13 ka shkuar të votoj në vendvotimin nr.0601C /02R dhe i është mohuar e drejta për të votuar me arsyetim se në duart e tija ka shenja të ngjyrës (sprejtit) dhe ka insistuar disa herë duke ju treguar se nuk ka votuar më herët. Arsyetimi i personave përgjegjës ishte se duar e tij kanë qenë të shënuara me materialin zgjedhor, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë emrat e Kryesuesi dhe antarve të vendvotimit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-i me datë 16.06.2014 e informoi Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, për ankesën që është bërë dhe kërkoi nga KQZ-ë, numrat kontaktues për kryesuesin e atij vendvotimi si dhe të komisioneve të cilët kanë qenë dëshmitarë.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga KQZ.

PZAP, mori deklaratën nga Kryesuesi i Vendvotimit nr. 0601C/02R në të cilën ai deklaroi se antari i vendvotimit i cili bën spërkatjen e gishtave të votuesve ka hasur një person i cili në duar e tija rezulton se kishte spërkatës të materialit zgjedhorë ai pohoi se personat të cilët kanë qenë të angazhuar për ditën e Zgjedhjeve obligimin për të votuar është dashur ta kryejnë në mëngjes pasi që duar e tyre mund të figuronin ngjyra e materialit zgjedhor. Po ashtu edhe Komisionerin i AAK-së, deklaroi se personit në fjalë i ka rezultuar spërkatës në gishtat e tij. Ata theksuan se refuzimin për të votuar të personit në fjalë e kanë bërë me arsyetimin se vepruar në bazë të Rregullave Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

## **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore janë te pa bazuar ngase nga dëshmit qe ka marr nga Kryesuesi i vendvotimin dhe Komisioneri i vendvotimit thuhet se presoni ne fjale ne momentin kur ka hyr ne vendvotim dhe iu është drejtuar zyrtarit për spërkatjen e gishtit, aty ka rezultuar se i njëjti ka pasur gishtin e spërkatur me herët, dhe është dyshuar për tentim te votimit te dyfishtë. Në bazë të Rregullës Zgjedhore neni 17.5 *Pasi që votuesi të nënshkruajë në LPV, atij/asaj duhet ti spërkatet gishti i djathtë tregues, ose cilido gisht tjetër nëse nuk ka gisht tregues, dhe pastaj votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm të vulosur për zgjedhje.*

Për këtë arsye edhe është refuzuar votimi i tij. Dëshmitë e ofruara nga pala ankuese nuk janë të mjaftueshme për të vetëtuar një shkelje te tillë nga ana e Kryesuesit dhe Komisionerve të tjerë, dhe nuk janë të argumentuara, prandaj, PZAP-i, konstatoi se ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

Anr.355/2014 më datën 16.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*